

DY QEVERI – NJË PANDEMI

Raport me infografika
mbi monitorimin e masave
kundër COVID-19 në Kosovë


Periudha: Mars -Gusht 2020



PËRMBAJTJA

- 1 Masat e marra nga Qeveria
- 2 Mbyllja totale
- 3 Kriza shëndetësore e shkaktuar nga COVID-19
- 4 Udhëtimet gjatë pandemisë COVID-19
- 5 Orari i Lëvizjes
- 6 Hapja problematike
- 7 Arsimi
- 8 Aspekti ekonomik
- 9 Pakoja fiskale

MASAT E MARRA NGA QEVERIA



Më 10 Mars 2020, filluan përpjekje të shumta për menaxhimin e Pandemisë COVID19 në Kosovë.




Dy rastet e para të konfirmuara me virus COVID-19 në Kosovë u publikuan më 13 Mars 2020, datë e cila tregon dhe fillimin e karantinës në Kosovë.

Për dallim nga vendet e tjera në Kosovë gjatë pandemisë ka pasur edhe rrëzim të Qeverisë, nga Qeveria Kurti tek Qeveria Hoti, ndryshim ky i cili krijoi sfida të reja dhe vështirësi në parandalimin e përhapjes së Pandemisë.



**CORONAVIRUS
KARANTINË**

Nga muaji mars deri në fund të muajit maj, **gjithë vendi ishte në karantinim.**




Nga data 1 Qershor 2020, ku filloi faza e largimit të masave, **gjendja filloi të përkeqësohej shumë**, ku numri i të infektuarve dhe të vdekurve arrinte shifra marramendëse.

Qeveria u detyrua të krijojë sërish masa parandaluese, kufizime në staf dhe krijimin e dënimeve për ata që nuk vendosnin maska, në mënyrë që situata të kthehet në normalitet. Si pasojë në **muajin gusht, situata në vend ishte jashtë kontrollit.**

23

125

Gjatë qeverisë Kurti, e cila ishte në fuqi deri më datën 25 Mars 2020, janë marrë **125 vendime, nga të cilat 23 ose 18.4% kishin të bëjnë me Pandeminë COVID-19.** Të gjitha vendimet pas kësaj date i takojnë Qeverisë Hoti, e cila është ende në detyrë.



MBYLLJA TOTALE

Qeveria e Republikës së Kosovës, më 13 Mars 2020 publikoi vendimet rreth:

- **Mbylljes së kufijëve tokësor** për udhëtarë që hyjnë në Kosovë, përveç atyre që janë rezidentë të Kosovës
- **Ndalimi i transportit brenda Kosovës** si dhe transporti i organizuar ndërkombëtar;
- **Ndalimi i të gjitha linjave të udhëtimit ajror** në Aeroportin e Prishtinës, përveç fluturimeve ushtarake ose emergjente;



Udhëtimi ndërkombëtar ajror u pezullua dhe kufinj të mbyllën. Të gjithë udhëtarët e ardhur u vendosën në karantinim në kampusin studentor të Universitetit të Prishtinës për një periudhë dy javore.




Kompanitë private janë urdhëruar të kryejnë aktivitetet e tyre nga shtëpia (punë në distancë).



Ndalimi i funksionimit të gastronomisë, kafeneve, bareve, restoranteve, pubeve) mbyllja e qendrave tregtare, me përjashtim të tregut të barnave dhe tregjeve ushqimore;



Ndalimi i të gjitha aktiviteteve sportive, kulturore dhe të ngjashme;



Kriza shëndetësore shkaktuar nga COVID-19



Më 11 Mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim **për marrjen e masave parandaluese** në funksion të mbrojtjes nga Pandemia COVID-19.

Qeveria e Kosovës veprroi shpejtë, duke shpallur një **Urgjencë të Shëndetit Publik** për të gjithë vendin më **15 Mars 2020**.

Qeveria themeloi menjëherë një **Komitet Kombëtar për COVID-19, Koordinimi dhe Monitorimi**, i cili ka punuar me institucionet shëndetësore, Kombet e Bashkuara, agjencitë, autoritetet lokale të sigurisë, si dhe donator të tjerë ndërkombëtarë për të vendosur karantinë, aranzhimet dhe konrollet kufitare, si dhe evakuimin mjekësor të qytetarëve që kthehen.



Hapja është paraparë në tre (3) faza.

Ndërmjet fazave të pacaktuara do të bëhet rivlerësimi i situatës epidemiologjike si tregues më i besueshëm i mundësisë / nevojës për zbutjen apo rikthim të masave të fazës vijuese.

FAZA 1

Faza e parë ka nisur së zbatuari me disa lehtësime që nga **4 Maj 2020**.

FAZA 2

Faza e dytë ka nisur së zbatuari me **18 Maj 2020**.

FAZA 3

Faza e tretë ka nisur së zbatuari që nga **1 Qershor 2020**.

Udhëtimi gjatë pandemisë COVID-19

Aeroporti "Adem Jashari" që nga 28 Qershor 2020 nuk aplikon karantinë 2 javore. Ndërsa testi për COVID-19 nuk është obligativ por vetëm i rekomandueshëm.


Pikat kufitare në: **Merdarë, Vërmicë, Kullë, Hani i Elezit, Jarinjë dhe Dheu i Bardhë** janë hapur që nga 31 Maj 2020.



Pika kufitare të **Qafë Prush, Qafë Morinë, Muqibabë, Mutivodë** janë hapur që nga 22 Qershor 2020.


Të gjithë qytetarët e **Republikës së Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, dhe Bosnje e Hercegovinës** që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës duhet të dëshmojnë testin RTPCR negativ në COVID19, jo më të vjetër se 72 orë.

Si pasojë e rritjes së numrit të të infektuarve në Kosovë, si një lloj preventive ndaj përhapjes më të madhe të virusit, më 13 Korrik 2020 u vendos që **të gjithë banorët e Kosovës janë të obliguar që të bartin maska në fytyrë** në të gjitha aktivitetet jashtë shtëpive të tyre dhe **të mbajnë distancën prej 2m me njëri tjetrin.**




ORARI I LËVIZJEVE

Qeveria e Kosovës me qëllim të parandalimit dhe kontrollit të përhapjes së virusit COVID – 19 ka aplikuar masat e ndalimit të qarkullimit të qytetarëve në periudha të ndryshme dhe bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës.



MASAT MBROJTËSE NDAJ COVID - 19

Këto këshilla janë bazuar në burimet e Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës.



Hapja problematike

- **Reduktimi i punonjësve në administratë** vetëm në staf esencial dhe angazhimi i tyre me punë nga shtëpia (online), përgjysmimi i personave në secilën zyrë në përputhje me manualin.



- **Kontaktet duhet të vet-izolohen për 14 ditë në shtëpi**, dhe nuk duhet të kenë asnjë kontakt gjatë kësaj periudhe.



- **Kontaktet këshillohen për monitorim të shëndetit për 14 ditë** pas dates së fundit të ekspozimit dhe të kërkojnë kujdes të menjëhershëm shëndetësor nëse shfaqin ndonjë simptomë (ethe, temperature, kollitje, vështirësi në frymëmarrje ose diarre).

- Të mbyllen zyrat apo njësitë në të gjitha insitucionet publike, dhe bizneset private ku ka raste pozitive.



- **Ndalohe grumbullimet** në hapësirat e mbyllura dhe të hapura për **më shumë se 50 persona**.

- **Bartja e maskave të jetë obligative.**

- Të gjitha **subjekteve që ofrojnë shërbime të gastronomisë** iu ndalohe funksionimi nga ora 21:00 deri në 5:00 në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Jashtë këtij orari mund të punojnë vetëm në hapësira të hapura duke mbajtur distancën prej 1.5 metra, dhe me shërbimet take-away (merre me vete).



- **Ceremonitë mortore** të zhvillohen vetëm me rrethin e ngushtë familjar.



ARSIMI



Duke qenë të vetëdijshëm për mundësinë e përhapjes së shpejtë të kësaj pandemie në institucionet shkollore, me kohë është kërkuar rritja e higjienës në shkolla, dhe në bashkëpunim me Institutin Kombëtar për Shëndetin Publik (IKSHPK), janë dërguar udhëzime tek të gjitha institucionet arsimore për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së virusit.

PLAN I DETAJUAR I VEPRIMIT



Në përputhje me Planin Kombëtar për Reagim ndaj COVID19, të aprovuar nga Qeveria e Kosovës (100 Ditë Qeverisje e Mirë) me 10 Mars 2020, është përgatitur një **plan i detajuar i veprimit që është shpërndarë tek të gjitha Komunat/DKA-të, shkollat dhe institucionet edukative në vend.**

MËSIMI NË DISTANCË



Mësimi në distancë filloi të transmetohet në RTK më 23 Mars 2020, i cili përfshinte fillimisht klasët 1-5 dhe më vonë dhe ato 6-9.

PLATFORMAT ONLINE



Shume mësimdhënës të arsimit të mesëm të ulët dhe atij të lartë **përdornin platformat e ndryshme për mësimin online**, si: Zoom apo Google Classroom.

Gjatë periudhës së Pandemisë **u shpërndanë një numër i madh i paisjeve elektronike** për ato familje të cilat nuk kishin mundësi të fëmijët e tyre të ndiqnin mësimin në mënyrë virtuale.


Disa nga donatorët që mbështetën këtë iniciativë janë: GIZ, Banka Botërore, Elkos Group, Kompania Ecolog, dhe shumë organizata, biznese dhe qytetarë nga komunat e ndryshme të Kosovës kontribuan në këtë iniciativë.

NDËRPRERJA E PROCESIT MËSIMOR



Më 12 Mars 2020 **është ndërprerë procesi mësimor** dhe kanë filluar përgatitjet për realizimin e mësimin nga distanca i cili është realizuar në përputhje me planprogramet mësimore të Republikës së Kosovës.

PLATFORMAT MËSIMORE



Më 6 Prill 2020, filloi **transmetimi i më shumë se 70% të lëndëve mësimore, ku kishte një pjesëmarrje rreth 90% të nxënësve.**

SFIDAT E ARSIMIT NGA COVID-19

Mësimi online ishte dicka shumë e re për vendin tone dhe mjaft sfiduese për mësimdhënësit dhe nxënësit poashtu.

Gjendja e pandemisë pamundësoi mbajtjen e Testeve të Maturës dhe Semi Maturës në Kosovë, të cilat ishin paraparë të mbahen në fund të muajit Qershor dhe fillim të muajit Korrik.



Sa i përket studimeve jashtë vendit, gjatë periudhës së pandemisë **u rrit numri i bursave për studime në Universitetet Hungareze**, nga 50 në 75 për studentë nga Kosova.

ASPEKTI EKONOMIK

Pandemia COVID-19 paraqet jo vetëm një kërcënim serioz për shëndetin e njeriut, por edhe një tronditje të madhe për ekonominë e vendit. Pasojat negative në ekonomi kanë ndikuar thellësisht në NVM-të e Kosovës, ku 80% e bizneseve në Kosovë janë në këtë kategori.

Ministria e Financave



Më 18 Mars 2020, MF ka shtyer dorëzimin e pasqyrave vjetore financiare të ndërmarrjeve në Kosovë tek Këshilli i Raportimit Financiar në Kosovë (KCFR) deri më datën 30 Qershor 2020.

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike



Më 19 Mars 2020, MPBAP vendosi shtyerjen e dorëzimit të pasqyrave vjetore financiare të OJQ-ve deri më datën 30 Qershor 2020.

Ministria e Financave



Më 20 Mars 2020, MF ka shtyer afatin për paraqitjen e deklaratave tatimore, raporteve dhe pagesave, si dhe për shqyrtimin dhe vendimin mbi kërkesat në lidhje me rimbursimet, deri më 30 Prill 2020.

Ministria e Financave



Më 23 Mars 2020, MF ka shtyer afatin për pagimin e taksës së pronës (afati parë) deri më 30 Qershor 2020.

Ministria e Financave



Më 23 Mars 2020, MF ka përjashtuar përkohësisht nga pagesa e TVSH-së për importet e grurit dhe miellit, për prodhimin e bukës dhe produkteve të bukës.

Ministria e Ekonomisë, Punësisht, Tregtisë, Industrisë, Sipërmarrjes dhe Investimeve Strategjike



Më 23 Mars 2020, MEPTIS ka publikuar vendimin për pezullimin e përkohshëm të disa masave tarifore kundër importit të miellit deri më 30 Prill 2020.

Ministria e Financave



Më 24 Prill 2020 Administrata Tatimore e Kosovës informojë se afati i pagesës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve pensionale u zgjatë deri më 30 Qershor 2020.



Qëllimi i vendimit të MEPTIS për pezullimin e përkohshëm të disa masave tarifore kundër importit të miellit ishte që të sigurojë furnizimin e rregullt të miellit gjatë emergjencave të shëndetit publik në lidhje me sëmundjen e virusit korona (COVID-19).

Kjo ndodhi si pasojë e fokusit shumë të madh medial në këtë dukuri dhe panikut të krijuar nga qytetarët që nga fillimi i Pandemisë, të cilët ishin mjaft të shqetësuar se do të ketë ngesë të furnizimit të produkteve ushqimore.

Më 3 Prill 2020, Banka Qendrore e Kosovës prezantoi masat për të minimizuar sa më shumë që të jetë e mundur dëmin e shkaktuar në ekonomi si rezultat i pandemisë COVID-19.

Masat e marra nga BQK, përfshijnë:
- Sigurimin e funksionimit të duhur të sistemit të pagesave në tërë Kosovën.

- Dezinfektimin e rregullt të gjitha parave me të cilat BQK furnizon tregun, si masë mbrojtëse për përdoruesit e parave të gatshme.



Kredi-marrësit që kanë hasur vështirësi në gjenerimin e të ardhurave si rezultat i krizës pandemike, kanë pas të drejtë të aplikojnë në bankat e tyre për të shtyrë pagesën e këstit të huasë, nga 16 Marsi deri më 30 Prill 2020. BQK ka ndërmarrë të gjitha masat e duhura ligjore që interesi i ndëshkimit në lidhje me kreditë nuk do të zbatohet gjatë kësaj periudhe.

Më datën 29 Korrik 2020, aprovohet shtesa mujore në vlerë prej 300 € (mbi pagën bazë) vetëm për personelin publik shëndetësor për angazhim shtesë dhe për ekspozim të drejtpërdrejtë të rrezikut të infektimit në punën e tyre gjatë trajtimit të pacientëve me virusin COVID19, për muajin Korrik dhe Gusht 2020.





Pakoja fiskale

Qeveria e Kosovës, më 30 Mars 2020, mori vendim për **aprovimin e Pakos Emergjente Fiskale** me 15 masa në vlerë prej rreth 179.65 milionë eurosh pët t'iu adresuar nevojave të krjuara në vend gjatë pandemisë Covid-19. Këto mjete janë ndarë për të subvencionuar sektorin privat (përfshirë punëtorët), për të ndihmuar përfituesit e skemave sociale dhe ndërmarrjet publike, komunitet e Kosovës, komunitetet pakicë, punëtorët e sektorit publik në vijën e parë të frontit dhe për të ndihmuar prodhimin bujqësor në mënyre që të tejkalohet gjendja e tyre e vështirë.

1

Pagesë të dyfishtë të vlerës së skemës sociale për të gjithë përfituesit të skemave sociale për muajtë mars, prill dhe maj.

2

Pagesë shtesë prej 30 € në muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesë mujore në vlerë më të ultë se 100 € për muajtë prill, maj dhe qershor.

3

Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që janë në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik.

- a) Paga mujore të punonjësve në vlerë prej 170 € për muajin prill dhe maj;
- b) Subvencionimi i qirasë deri në 50% të vlerës së qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për muajin prill dhe maj;
- c) Vlera e kontributeve pensionale për pagat lidhur me masat e parapara me këtë vendim për muajin prill dhe maj.

4

Huadhënie pa interes për ndërmarrjet publike që kanë vështirësi financiare për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, me qëllim të sigurimit të likuiditetit të përkohshëm të tyre, me kthim deri më 31.12.2020.

5

Mbështetje shtesë financiare për Komunitet e Republikës së Kosovës që janë ndikuar nga përballja me pandeminë.

6

Shtesë mbi pagë në vlerë prej 300 € për punëtorët në terren që janë të ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në vendin e tyre të punës për muajin prill dhe maj.

7

Pagesë shtesë në vlerë prej 100 € për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave dhe farmacive për majin prill dhe maj.

8

Asistencë mujore në vlerë prej 130 € për qytetarët që humbin vendin e tyre të punës për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, për muajin prill, maj dhe qershor.

9

Mbështetje për iniciativat dhe projektet që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo-shumicë në Republikën e Kosovës, që janë goditur më rëndë nga situata e emergjencës së shëndetit publik.

10

Sigurimi i likuiditetit financiar për mikro-ndërmarrjet dhe të vetëpunësuarit. Nëpërmjet programeve të caktuara të Fondit për Garantimin Kreditor të Kosovës të ofroj shumën prej 10,000 € euro për periudhën 24 mujore.

11

Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për rritje të prodhimit bujqësor.

12

Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për evitimin e situatës së krijuar nga situata e emergjencës së shëndetit publik në aktivitetet sportive dhe kulturore.

13

Mbështetje për eksportuesit në Republikën e Kosovës pas përfundimit të situatës së emergjencës së shëndetit publik.

14

Mbështetje për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune së paku një (1) vjeçare gjatë periudhës së situatës së emergjencës së shëndetit publik, me 130 € për dy muajt pasues pas regjistrimit.

15

Asistencë mujore në vlerë prej 130 € për qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent, që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Kosovës, për muajin prill, maj dhe qershor.

REFERENCAT

- ★ Masat Për Adresimin e COVID-19 Nga Perspektiva Gjinore Rekomendime Për Qeverinë e Kosovës. Rrjeti i Grupit Të Grave, Apr. 2020, womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/04/Masat-për-adresimin-e-COVID-19-nga-perspektiva-gjinore_Rekomandime-për-Qeverinë-e-Kosovës_04_04_2020.pdf.
- ★ "Vendimi 01/04 i Qeverisë së Kosovës ." Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Kosovës, June 2020, kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/06/Vendimi-nga-Mbledhja-e-4-të-e-Qeverisë-3.pdf.
- ★ "Vendimi 01/09i Qeverisë Së Kosovës ." Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Kosovës, July 2020, kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendimet-e-Mbledhjes-së-9-të-të-Qeverisë.pdf.
- ★ "Vendimi 01/10 i Qeverisë Së Kosovës ." Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Kosovës, July 2020, kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendimet-nga-mbledhja-e-10-të-e-Qeverisë-1.pdf .
- ★ "Vendimi 25/2020 i Qeverisë Së Kosovës ." Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Kosovës, Mar. 2020.
- ★ "Vendimi 01/10 i Qeverisë Së Kosovës ." Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Kosovës, July 2020, www.kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendimet-nga-mbledhja-e-10-të-e-Qeverisë-1.pdf.
- ★ "Vendimi 22/20 i Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. March 2020. Accessed June 2020. https://www.scaak.org/uploads/files/2020/March/24/Untitled_design1585059066.pdf.
- ★ "Vendimi 01/06 Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. March 2020. Accessed August 2020. https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2020/04/Vendim-per-korrigjimin-e-Vendimit-te-MTI-se-ref.01.nr_.15-e-dates-19...-1.pdf.
- ★ "Vendimi 43-1 I Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. April 2020. Accessed June 2020. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FD7B7555-F74A-4A67-AC0F-52129378DD10.pdf>.
- ★ "Vendimi 01/05 I Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. June 2020. Accessed August 2020. <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/06/Vendimet-e-Mbledhjes-së-5-të-të-Qeverisë.pdf>.
- ★ "Vendimi 01/12 I Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. July 2020. Accessed August 2020. <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendimet-nga-mbledhja-e-12-të-e-Qeverisë.pdf>.
- ★ "Vendimi 01/14 I Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. July 2020. Accessed August 2020. <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendimet-nga-mbledhja-e-14-të-e-Qeverisë.pdf>.
- ★ "Vendimi 01/15 I Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. July 2020. Accessed August 2020. <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendimet-nga-mbledhja-e-15-të-e-Qeverisë.pdf>.
- ★ "Vendimi 01/18 i Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. July 2020. Accessed August 2020. <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendimet-nga-mbledhja-e-18-të-e-Qeverisë.pdf>.
- ★ "Pakoja Emergjente E Qeverisë Nuk Ndihmon Bizneset, Më Shumë Sociale Sesa Fiskale." Ekonomia Online. April 05, 2020. Accessed September 15, 2020. <https://ekonomiaonline.com/ekonomi/pakoja-emergjente-e-qeverise-nuk-ndihmon-bizneset-me-shume-sociale-sesa-fiskale/>.
- ★ "Vendimi 01/19 I Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. April 2020. Accessed July 2020. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/8053C963-0048-4F21-AF6A-383A396B7578.pdf?fbclid=IwAR2StjMk45cFWv6KzvdmsSEjtgIKa1f9JsFJK-EUIqoRgKAq5Mt1JBjRklw>.
- ★ Alaj, Njomza. "Notice to Taxpayers - Compensation Is Also Provided for the Self-Employed, Salaries and Rents Paid." Administrata Tatimore E Kosovës. April 20, 2020. Accessed September 15, 2020. <http://www.atk-ks.org/en/mundesohet-edhe-kompensimi-per-te-vetepunesuarit-pagat-dhe-qirate-e-paguara/>.

- ★ Alaj, Njomza. "Notice to Taxpayers - Additional Payment for Employees of Grocery Stores, Bakeries and Pharmacies." Administrata Tatimore E Kosovës. April 21, 2020. Accessed September 15, 2020. <http://www.atk-ks.org/en/njoftim-per-tatimpagues-pagese-shtese-per-punetoret-e-dyqaneve-ushqimore-furrave-dhe-barnatoreve/>.
- ★ "Measures Taken – COVID 19 - COVID-19." SCAAK. Accessed September 15, 2020. <https://www.scaak.org/En/informacione-per-covid-19/1707/measures-taken-ndash-covid-19/>.
- ★ "Vendimi 01/09 I Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. March 2020. Accessed August 2020. <https://kryeminstri-ks.net/wp-content/uploads/2020/05/Vendimet-e-mbledhjes-së-9-të.pdf>.
- ★ Deloitte. "COVID-19 Kosova." June 2020. Accessed August 2020. https://www.deloitte.com/content/dam/Deloitte/al/Documents/legal/Deloitte_Kosova_Newsletter_COVID-19_ALB.pdf.
- ★ "Vendimi 01/07 I Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. June 2020. Accessed August 2020. <https://kryeminstri-ks.net/wp-content/uploads/2020/06/Vendimet-e-Mbledhjes-së-7-të-të-Qeverisë.pdf>.
- ★ "Vendimi 01/05 i Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. June 2020. Accessed September 2020. <https://kryeminstri-ks.net/wp-content/uploads/2020/06/Vendimet-e-Mbledhjes-së-5-të-të-Qeverisë.pdf>.
- ★ "Vendimi 01/11 I Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. June 2020. Accessed August 2020. <https://kryeminstri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendimi-nga-Mbledhja-e-11-të-e-Qeverisë.pdf>.
- ★ "Vendimi 01/12 i Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. July 2020. Accessed September 2020. <https://kryeminstri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendimet-nga-mbledhja-e-12-të-e-Qeverisë.pdf>.
- ★ "Vendimi 01/13 i Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. July 2020. Accessed September 2020. <https://kryeminstri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendimet-nga-mbledhja-e-13-të-e-Qeverisë.pdf>.
- ★ "Vendimi 01/17 i Qeverisë Së Kosovës." Zyra E Kryeministrit. July 2020. Accessed July 2020. <https://kryeminstri-ks.net/wp-content/uploads/2020/07/Vendim-nga-mbledhja-e-17-të-e-Qeverisë.pdf>.
- ★ KDI - Pakoja fiskale emergjente / Analizë e shkurtër, 2020. <http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2020/08/50-Analiz%C3%AB-e-Shkurt%C3%ABr-e-Pakos-Fiskale-Emergjente-ALB-02.pdf>

DY QEVERI - NJË PANDEMI

Raport me infografika mbi monitorimin e masave kundër COVID-19 në Kosovë

Mbledhja e të dhënave: Donika Blaku dhe Fitore Gjata

Rishikimi i brendshëm: Donika Emini

Dizajni grafik: Fleta Baraku

COPYRIGHT © 2020. Platforma CiviKos.

Platforma CiviKos i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit apo bartjes në asnjë formë, duke përfshirë edhe fotokopjimin apo sistem tjetër të ruajtjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim. Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jokomerciale.

www.civikos.net
info@civikos.net